



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR

Nr. 6721 Prot

Shkodër, më 27.3.2025

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR** ✓

**Të nderuar Këshilltarë,**

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim:

**PËR**  
**“ STREHIMIN EMERGJENT TË FAMILJES SH.M DHE TË FAMILJES O.H**  
**(BANESAT SOCIALE ME QIRA TË NGRITURA PËR KOMUNITETIN ROM)”**

*Duke Ju uruar punë të mbarë!*

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**  
**ZV/KRYETAR**  
**Alban PREKA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025

**PËR**

**“STREHIMIN EMERGJENT TË FAMILJES SH.M DHE TË FAMILJES O.H  
(BANESAT SOCIALE ME QIRA TË NGRITURA PËR KOMUNITETIN ROM)”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 2, pika 25 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar; VKM - së nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore; VKB-së nr.29, datë 03.06.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin Rom dhe “Për miratimin e Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin Rom”; kërkesës me nr.5840 datë 12.03.2025 të Sh.M, kërkesës me nr.6276 datë 19.03.2025 të O.H, procesverbalit të strukturës përgjegjëse të strehimit, akt-verifikimit të grupit të punës, ngritur sipas Urdhrit nr.1734 datë 04.12.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kushteve të strehimit”, pas shqyrtimit të relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër me nr.\_\_\_\_prot, datë \_\_\_\_\_,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë strehimin emergjent të familjes SH.M dhe të familjes O.H tek Banesat Sociale me Qira të ngritura për komunitetin rom.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI  
ZV/KRYETAR  
Alban PREKA**



Zv/Kryetar

Teuta Gjetoza

Drejtoria e Shërbimeve Sociale Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Arleinda Kruja

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore  
dhe Shërbimeve Mbështetëse

Deris Vesha

Drejtoria Juridike

Marjola Fushkodi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT DHE SHËNDETIT  
PUBLIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025

### RELACION

“ PËR STREHIMIN EMERGJENT TË FAMILJES SH.M DHE TË FAMILJES O.H  
( BANESAT SOCIALE ME QIRA TË NGRITURA PËR KOMUNITETIN ROM)”

### KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Me datë 12.03.2025, me anë të kërkesës me nr.5840 prot., z.Sh.M na përcjell problematikën në lidhje me kushtet e vështira të banimit dhe problemet e shumta social-ekonomike të familjes së tij.

Menjëherë stafi i drejtorisë së Shërbimeve Sociale bashkë me anëtarët e Grupit të punës të ngritur sipas Urdhrit nr.1734 datë 04.12.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kushteve të strehimit”, realizuan verifikimi në terren për familjen M.

Nga e gjithë praktika e ndjekur si rrjedhojë e bashkëpunimit të strukturave përkatëse të Bashkisë Shkodër rezulton se:

Familja i përket komunitetit rom dhe përbëhet nga 4 anëtarë: kryefamiljari Sh.M, bashkëshortja L.M dhe fëmijët e mitur K.M dhe M.M

Sa i përket gjendjes social-ekonomike të familjes, paraqitet në kushte të vështira.

Të ardhurat e familjes sigurohen nga grumbullimi i materialeve të riciklueshme nga ana e bashkëshortit, burim i paqëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm për të siguruar jetesën e familjes.

Vajza e tyre, K.M, ka probleme të rënda shëndetësore, përfshirë diabetin, humbjen e ndjenjave dhe probleme me tiroiden. Për shkak të kushteve të vështira, familja shpesh nuk ka mundësi të sigurojë mjekimin e nevojshëm për K.M, duke mos marrë shpeshherë trajtimin e duhur.

Familja ka nevojë për një strehim që të jetë sa më afër spitalit, për të mundësuar K.M marrjen e mjekimit në kohë dhe të sigurojë ndihmën e nevojshme për t'u përballur me vështirësitë shëndetësore që ajo paraqet.

Me datë 19.03.2025, me anë të kërkesës me nr. 6276 prot., z.O.H na përcjell problematikën në lidhje me kushtet e vështira të banimit dhe problemet e shumta social-ekonomike të familjes së tij.

Sikurse për familjen tjetër, stafi i drejtorisë së Shërbimeve Sociale bashkë me anëtarët e Grupit të punës të ngritur sipas Urdhrit nr.1734 datë 04.12.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kushteve të strehimit”, realizuan verifikimin në terren për familjen H.

Nga vlerësimet dhe verifikimet e bëra rezulton se:

Familja i përket komunitetit rom përbëhet nga 4 anëtarë: kryefamiljari O.H, bashkëshortja A.H dhe fëmijët e mitur J.H dhe E.H

Sa i përket gjendjes social-ekonomike të familjes, paraqitet në kushte të vështira.

Të ardhurat e familjes sigurohen nga O.H i cili rezulton i punësuar pranë një subjekti privat me pagë 46,240 lekë, ndërsa bashkëshortja nuk punon, kujdeset për foshnjën e porsalindur, prematurë dhe vajzën 2 vjeçare.

Gjatë verifikimit në terren të strukturave të banimit, për të dy rastet , u vunë re probleme të dukshme që lidhen me sigurinë dhe shëndetin e individëve që jetojnë në këto struktura.

Kemi të bëjmë me struktura të përziera me elemente druri, copëza të ndryshme (pëlhurë, plastmasë) përfshirë edhe inerte, të cilat nuk ofrojnë qëndrueshmëri dhe izolim nga elementët dhe kushtet atmosferike.

Kjo ka sjellë mungesë të izolimit të duhur duke kontribuar në krijimin e kushteve të pasigurta për familjet në fjalë.

Gjendja e përgjithshme e ambientit është shumë shqetësuese. Ka prani lagështie të theksuar që përkeqësojnë ndjeshëm cilësinë e jetesës.

Ambientet ku qëndronin familjet ishin jashtë çdo kushti optimal jetik për banim.

Në kuadër të menaxhimit të rasteve, janë kryer hapat e mëposhtëm nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- Vlerësim fillestar, dhe vlerësim i nevojave të familjes.
- Referuar tek organizata “Shpresë për Botën” për pako ushqimore dhe higjieno sanitare;
- Referuar për veshje pranë organizatës “Shpresë për Botën”.

Nga sa më sipër, në zbatim të VKM-së nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, në të gjitha situatat e gjendjes së emergjencës, kur procedura fillon me kërkesë të individit/familjes përfituese, ose kryesisht nga vetë njësi e vetëqeverisjes vendore, emri/at/ lista e aplikantëve paraqitet/n menjëherë në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për miratim.

Duke qenë në kushtet e nevojës emergjente për strehim, propozojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak, strehimi emergjent për familjen e z. Sh.M dhe familjen e z.O.H. tek Banesat Sociale me Qira të ngritura për komunitetin rom.

Ju ftojme të miratoni projekt-vendimin “ Për strehimin emergjent të familjes së z.Sh.M dhe familjes së z.O.H. tek Banesat Sociale me Qira të ngritura për komunitetin rom.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV/KRYETAR**

**Alban FREKA**



**Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik**

Arlinda KRUIJA













